

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Salvatore Aliu u martua me një ruse, por s'i shpëtoi dot SPAK
ADRESA	https://joq-albania.com/artikull/1394584.html
BURIMI	joq-albania.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 08:27:00 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	28 shtator 2026, 08:20:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 28 shtator 2026, 08:19:00 UTC → 28 shtator 2026, 08:21:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	afe09969c1c9fd994169e64795b8d83ebf827c7f6b932a16614d496830b3836b
TEKSTI	dd0996ea86a566d8ae4474abeb3156502b521b274342856c2f4a6dbd1b42de96
PAMJA	c3a663eae248c055cc1b9a479751cc470f7fca23fc68c183d685a9eab568bf7c

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	d0eed6a236be38067391de8516a957497532930aa9a9844b5acd22773a449d45
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	f736abde33fe298fdab4b0ac01389ddc82e49c4df4ee1e7f323305e5a671536d
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/d0eed6a236be38067391de8516a957497532930aa9a9844b5acd22773a449d45>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Salvadore Aliu u martua me një ruse, por s'i shpëtoi dot SPAK

Shkruar nga: I Cani | Publikuar më: 28.09.2026, 10:20



Share



Share



Detaje të reja janë bërë publike lidhur me arrestimin në Rusi të Shpëtim Aliut, i shpallur në kërkim ndërkombëtar nga autoritetet shqiptare me "pullë të kuqe" të Interpolit për akuzat për trafik droge dhe grup të strukturuar kriminal.

Rreth një javë më parë, Interpol Moska ka njoftuar Interpol Tiranën për ndalimin e shtetasit shqiptar. Sipas të dhënave të bëra publike, Aliu ishte larguar nga Dubai drejt Moskës pas problemeve që pati me drejtësinë shqiptare në qershor 2026, duke tentuar t'i shpëtonte një arrestimi të mundshëm në Emiratet e Bashkuara Arabe dhe ekstradimit drejt Shqipërisë.

Sipas gazetarit Elton Qyno, largimi drejt Rusisë lidhej edhe me martesën e Aliut me një shtetase ruse. Ai dyshohet se kishte zgjedhur të vendosej në Rusi duke u mbështetur te bashkëshortja e tij dhe duke fshehur identitetin e vëndndodhjen.

Identifikimi i gruas thuhet se ka ndihmuar autoritetet në përcaktimin e vëndndodhjes së Aliut, i cili më pas është arrestuar nga policia ruse.

Pas arrestimit, SPAK ka nisur procedurat për ekstradimin e tij drejt Shqipërisë. Prokuroria e Posaçme i ka dërguar një letërporosi Federatës Ruse, përmes Ministrisë së Jashtme, me qëllim sjelljen e tij përpara drejtësisë shqiptare.

Aliu u shpall në kërkim pas aksionit të 16 qershorit, ku u godit një grup i dyshuar për trafik ndërkombëtar të kokainës nga Amerika Latine dhe pastrim parash. Ndaj tij rëndojnë akuzat për "Trafikimin e narkotikëve", "Pastrimin e produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", "Grupin e strukturuar kriminal" dhe "Kryerjen e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal".


Në komunikimet e bardhura nga Sky ECC, Aliu shfaqet me disa nofka, mes tyre "Daja", "Qero", "Qerosi", "Viktor" dhe "Albo Pelon".

Sipas dosjes hetimore, ai dyshohet se ka pasur një rol të rëndësishëm në qarkullimin dhe investimin e parave të dyshuara si të ardhura nga aktiviteti kriminal, përmes bizneseve në sektorin e ndërtimit dhe pasurive të paluajtshme.

Po sipas hetimeve, Salvatore Aliu dyshohet se ka qenë një prej furnitorëve kryesorë me kokainë për grupet e lidhura me Eldi Dizdarin, Dritan Gjickën dhe Armando Pacanin. Autoritetet shqiptare dyshojnë gjithashtu se përmes aktivitetit kriminal dhe skemave të investimit janë pastruar në Shqipëri të paktën 30 milionë euro, me ndihmën e vëllait të tij, Isa Aliu.

Tashmë pritet që autoritetet ruse të shqyrtojnë kërkesën e Shqipërisë për ekstradimin e tij.

FACT CHECK: Synimi i JOQ Albania është t'i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e [raportoni këtu](#).



Më të Lexuarat



Albanian Media House

ARTIKULL JOETIK?

JUQ Sondazn
KLIKO PËR TË VOTUAR

TË NGJASHME

Më të fundit



Dërgo materialin tënd këtu >

[Puno me ne!](#)

[Marketing](#)

[Politika e privatësisë](#)

[Rreth Nesh](#)

[Kushtet e përdorimit](#)

[Kontakt](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.